

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të dënuarit S.G., nga fshati P., komuna e S., për shkak të veprës penale shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza nga neni 298 par.1 nënpar.2 të Kodit mbi Doganën dhe Akcizën në Kosovë, nr.03/L-109 duke vendosur lidhur me kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit, av. Bashkim Nevzati, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.182/2015 datë 3.2.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.193/2017 datë 11.5.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8 maj 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit S.G., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.182/2015 datë 3.2.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.193/2017 datë 11.5.2017, ndërsa çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.182/2015, e datës 3.2.2017, i dënuari është shpallur fajtor për shkak të veprës penale shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza nga neni 298 par.1 nënpar.2 të Kodit mbi Doganën dhe Akcizën në Kosovë, nr.03/L-109 dhe është gjykuar me dënim me kusht, ashtu që i është vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i dënuari në afat prej 2 (dy) viteve, nuk kryen vepër tjetër penale si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 €. I dënuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën financiare të paguajë shumë prej 400 € ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Njëkohësisht i dënuari është obliguar që palës së dëmtuar Dogana e Kosovës në emër të shmangies mashtruese nga taksa e importit dhe akcizës t'i paguajë shumë prej 120.395,60 €, në afat prej 6 (gjashtë) muaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit, me aktgjykimin PA1.nr.193/2017 e datës 11.5.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. B. N., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që ndaj të dënuarit të pushon procedura penale ose të anulohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje.

Prokurori i Shtetit me shkresën KMLP.II.nr.111/2017 e datës 10.7.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes e në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit, av. B.N., pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale duke mos i cekur saktësisht cilat dispozita por thekson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrimin e ndjekjes penale sepse ndjekja penale është bërë pas skadimit të afatit 5 (pesë) vjeçar ku fatura e fundit e inkriminuar është para datës 26.2.2010, po ashtu konsideron se në dispozitiv nuk është përcaktuar afati kohor i kryerjes së veprës penale por është thënë se "...në periudhën kohore 2007-2010" dhe është dashur që të përcaktohet saktësisht koha e kryerjes së veprës mu për shkak të dispozitave ligjore të cilat janë të lidhura me parashkrim. Më tutje në kërkesë pretendohet se të dy instancat gjyqësore e pranojnë veprimin në kontinuitet-veprën penale në vazhdim edhe pse sipas dispozitave të KPK të vitit 2004 kjo vepër nuk ekziston, ndërkaq gjykata e shkallës së parë e bazon aktgjykimin në dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e duke i anashkaluar dispozitat lidhur me parashkrimin e kërkesës materiale e cila është e përcaktuar në 3 (tri) vjet si dhe e obligon të pandehurin në pagesën e shumës prej 120.000 € edhe pse lidhur me këtë nuk ka pasur propozim në aktakuzë e aq më tepër si e dëmtuar paraqitet Dogana e Kosovës e cila asnjëherë as që është paraqitur e as që është ftuar në këtë cilësi dhe si e tillë nuk ka paraqitur kërkesë pronësoro – juridike. Të gjitha këto bëjnë që të tejkalohet identiteti i aktakuzës edhe pse sipas dispozitës së nenit 360 par.1 të KPPK, taksativisht parashihen veprimet e domosdoshme të ndryshimit dhe plotësimit të aktakuzës, andaj çdo intervenim në këtë drejtim është shkelje, ndërkaq gjykata e shkallës së dytë me rastin e shqyrtimit të ankesave ka shkelur dispozitën e nënti 390 par.1 të KPPK, ngase nuk i ka njoftuar parashtruesin e ankesës e as të pandehurin për datën e mbajtjes së shqyrtimit para kolegjit të shkallës së dytë.

Gjykata Supreme duke i vlerësuar pretendimet e cekura në kërkesë gjen se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të

procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 të KPPK lidhur me nenin 459 par.2 dhe 460 par.4 dhe 463 par.1 dhe par.2 të KPPK. Kjo gjykatë nga shkresat e çështjes gjen se Dogana e Kosovës si e dëmtuar asnjëherë nuk ka marrë pjesë në seancat gjyqësore të caktuara edhe pse çdo herë është konstatuar se mungon dhe se duhet të ftohet në cilësinë e të dëmtuarës. Po ashtu, nga shkresat vërtetohet se Dogana e Kosovës ka bërë kallëzimin penal ndaj të dënuarit dhe se me këtë rast është potencuar vlera e dëmit të shkaktuar nga i dënuari por në këtë kallëzim penal nuk është paraqitur kërkesa pasurore-juridike në këtë vlerë. Konform nenit 459 par.1 të KPPK, kërkesa pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale vendoset me propozimin e personave të autorizuar në procedurën penale në qoftë se kjo nuk e zvarrit procedurën penale në mënyrë të konsiderueshme, e në rastin konkret meqë lartësia e dëmit të shkaktuar ka qenë element i figurës së veprës gjykata sipas detyrës zyrtare ka vërtetuar shumën e dëmit ,por, gabimisht ka aplikuar nenin 463 par.1 dhe par.2 të KPPK kur ka vendosur ta obligoj të dënuarin që t'ia kompensoj shumën e vërtetuar Doganës së Kosovës, sepse nuk ka mundur me aktgjykim të vendos për kërkesën pronësoro juridike sepse e njëjta fare nuk ka ekzistuar. Për më tepër gjykata e shkallës së dytë bënë të njëjtin gabim kur e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë, e që e bënë pretendimin e mbrojtjes të bazuar.

Në rishqyrtim gjykata e shkallës së parë duhet të ftoj të dëmtuarën Dogana e Kosovës dhe ta informoj sipas nenit 460 par.4 të KPPK dhe pastaj varësisht nga fakti se a ka kërkesë pasurore juridike apo jo të vendos në kuadër të kompetencave të veta.

Nga të gjitha këto që u tha më lartë e duke u bazuar në nenin 438 par.1 pika 1.2. të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr. 162/2017, më 8 maj 2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,

Nesrin Lushta